



VENDIM

Nr.101 Datë 30.09.2011

PËR FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË "HEC LANABREGAS" SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma "a", neneve 9 dhe 13 pikat 1, gërma "d", të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gërma "g", nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të "Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave ", të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma a, dhe 3, të "Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s", miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.09.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "HEC LANABREGAS" sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "HEC LANABREGAS" sh.p.k, plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin teknik (nenin 9, pika 4.10) që ka të bëjë me sasinë e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar; kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit dhe listën e kontratave të mëparshme të realizuara, nuk është dhënë asnjë informacion nga ana e subjektit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë "HEC LANABREGAS" sh.p.k në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI
Në mungesë dhe me porosi
Entela SHEHAJ